

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shënohet rasti i parë i vdekjes në Kosovë nga Virusi i Nilit Perëndimor
ADRESA	https://www.syri.net/kosova/917414/shenohet-rasti-i-pare-i-vdekjes-ne-kosove-nga-virusi-i-nilit-perendimor/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 17:16:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 16:02:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6d27fbcc24464d476eda1e60a52530df43e0b5f3e6303f619f30dd1318e183cd
TEKSTI	c77ffa0da9577be231ccd2f644b12237bdfa183a016ac7f5899e8cd052359adb
PAMJA	f1bf2b5ff2d08d6308e2079bba5f457be6d73a8606b8ac2ee13cc064edb5ed28

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a7e700d06a12168b5a970530a9d2f826e6fa0ae118e49ae354ddd629e6204d9d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a0e62f20f1566f1a6ab80e6e4e50c1c4744bc54a84695e6ceb27bc326e386c4d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a7e700d06a12168b5a970530a9d2f826e6fa0ae118e49ae354ddd629e6204d9d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Shënohet rasti i parë i vdekjes në Kosovë nga Virusi i Nilit Perëndimor

18:02, 17/09/2026

Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) ka njoftuar se më 15 shtator 2026 është regjistruar rasti i parë i vdekjes së një pacienti të diagnostikuar me Virusin e Nilit Perëndimor (WNV).

Sipas njoftimit të Klinikës Infektive, pacienti Rr. I., i lindur më 2 maj 1960, ishte hospitalizuar më 10 shtator në gjendje të rëndë klinike, me diagnozën meningoencephalitis acuta.

Para hospitalizimit, pacienti ishte trajtuar në mënyrë ambulatorë për pesë ditë. Në ditën e pranimit në Klinikën Infektive, atij iu kryen ekzaminimet e nevojshme diagnostikuese dhe iu iniciua menjëherë trajtimi, në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore.

Në kuadër të ekzaminimeve laboratorike, pacientit iu realizua edhe analiza RT-PCR për Virusin e Nilit Perëndimor, e cila rezultoi pozitive.

QKUK-ja ka bërë të ditur se gjendja shëndetësore e pacientit vazhdoi të ishte tejet e rëndë, duke kërkuar trajtim intensiv.

'Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë të gjitha masat dhe procedurat e nevojshme mjekësore, si dhe është vazhduar trajtimi medikamentoz konform gjendjes klinike', thuhet në njoftim.

Megjithatë, përkundër përpjekjeve të stafit mjekësor dhe trajtimit të ofruar, pacienti ka vdekur në orën 08:40 të datës 15 shtator 2026.

Ky është rasti i parë i vdekjes së një pacienti të diagnostikuar me Virusin e Nilit Perëndimor, të cilin QKUK-ja e ka konfirmuar përmes njoftimit të Klinikës Infektive.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Hashim Thaçi reagon pas vendimit në Hagë: Mohoj çdo përfshirje në vrasje, do ta apeloj vendimin



Bosch: Presidenti i ri i Kosovës, mbase mund t'i falë të dënuarit nga Specialja



Kurti pret Hamzën pas vendimit të Hagës, diskutojnë apelimin e aktgjykimit

Komentet

më të lexuarat

A e ndryshon vendimi i Hagës mënyrën si duhet parë UÇK-ja? Flet historiani Konrad Clewing! Faji individual, lufta e Kosovës dhe kufijtë...

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'

Granit Xhaka në mbështetje të çlirimtarëve: Luftuan në tokën e tyre për lirinë e atdheut!

Trupi gjyqësor: Krasniqi kishte dijeni për krimet, por nuk ndërmori hapa

PDK dërgon në Kushtetuese konstituimin

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

e Kuvendit

Gjykata Speciale: Katër të akuzuarit janë penalisht përgjegjës për krime lufte!

Kurti thirrje liderëve politikë: Ta zgjidhim çështjen e presidentit

TË NGJASHME

Hamza: Vendimi në Hagë i padrejtë, PDK do të ndërmarrë veprime konkrete

Protestë mbarëpopullore nesër në Prishtinë

Trajneri Franco Foda flet për largimin e Rrahmanit nga Kosova: Nuk ka bojkot

Protesta në Prishtinë/ Studentët kërkojnë drejtësi për ish-krerët e UÇK-së

Kur Albin Kurti paralajmëronte Kuvendin e Kosovës: VV nuk e njeh Gjykatën Speciale, ne nuk do të dorëzojmë luftëtarët e UÇK

Granit Xhaka në mbështetje të çlirimtarëve: Luftuan në tokën e tyre për lirinë e atdheut!

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafii i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net